



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DEÇANI / OPŠTINA DEČANI

**Drejtoria për Inspekcione**

**10 Nr. \_\_\_\_\_**

**Datë: 15.12.2020**

**Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës**

**Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për Inspekcione**

**Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2020**



Në Kuadër të Drejtoratit për Inspekcione gjatë vitit 2020, për kryerjen e detyrave të punës sipas lëmvive përkatëse kanë qenë të sistemuar; Inspektori i Tregut, Inspektori Sanitarë, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Aktvendim si punë sekondare), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë në vepër) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shëf i inspektorëve.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore si dhe kushtet higjienike dhe sanitare të objekteve dhe stabilimenteve.

Është karakteristikë e këtij viti raportues se Drejtoria për Inspekcione përveç punëve dhe detyrave të punëve të bazuar në ligjet, aktet nënligjore përkatëse, rregulloret komunale, dhe Planin e punës për vitin 2020, që nga data 12.3.2020 është ballafaquar me gjendjen e krijuar nga Pandemia COVID-19.

Situata e krijuar nga shfaqja e Pandemisë COVID-19, ka imponuar që shumë aktivitete të planifikuara me Planin e punës së Drejtoratit për vitin 2020, të anashkalohen, dhe prioritetet ndër të gjitha prioritetet të përcaktohet Zbatimi i masave të përcaktuara nga Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid 19, Ligjit për shëndetësi, manualit për mbrojtje nga përhapja e pandemisë Covid 19, vendimeve dhe udhëzimeve të Qeverisë së RKS-së dhe ministrive përkatëse, si dhe atyre të Shtabit Komunal Emergjent.

Fal angazhimit të vazhdueshëm të inspektorëve dhe me një bashkëpunim shumë të mirë me Shtabin Komunal për menaxhimin e pandemisë, QKMF-në dhe Policin e Kosovës është arritur që pasojat e përhapjes të jenë dukshëm më të vogla.

Në bashkëpunim me IKSHP për personat që kanë rezultuar pozitiv në testin për konstatimin e Covid 19, janë ndërmarr veprimet për karantinimin e të njëjtëve me qëllim të ndalimit të përhapjes së pandemisë.

Krahas atyre të lartcekurave, janë bërë kontrole inspektuese si detyra të zakonshme si; lidhur me ndërtimet pa leje si dhe të atyre në kundërshtim me lejet e lëshuara nga Drejtorati për Urbanizëm, nga Inspektori i Veterinës si kompetencë e deleguar nga Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit është bërë mbikëqyrja e therjes së kafshëve dhe vulosja e mishit të therur neper thertore, është përcjell gjendja e ndotjes dhe degradimit të ambientit, minimumi ekologjik i sasisë së ujit në Lumëbardhin e Deçanit si rezultat i operimit të hidrocentraleve dhe për rastet kur Operatori ekonomik nuk i është përmbajtur elaboratit mbi minimumin ekologjik të sasisë së ujit në shtratin e lumit e për të gjeturat e konstatuara vazhdimisht janë njoftuar inspektorët kompetent të MMPH, është bërë evidentimi i deponive ilegale në terë territorin e Komunës. Është bërë kontrollim i rregullt i subjekteve afariste qoftë e sidomos atyre të tregtisë apo atyre hoteliere, sidomos sa i përket respektimit të masave të përcaktuara anti Covid 19, afatit të skadimit të produkteve ushqimore, mashtrimit të konsumatorëve, respektimit të orarit të punës etj. Në ditën e tregut është bërë mbikëqyrja e tregut të gjelbër edhe pse i njëjti për shkak të masave anti Covid 19 pjesën më të madhe të vitit ka qenë i mbyllur. Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura në subjektet tregtare, ku vlen të theksohet se ka ekzistuar një bashkëpunim mjaft i mirë.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe të mbrojtjes në punë.



**Gjatë vitit 2020 inspektoret kanë kryer aktivitetet si ne vijim:**

<b>Inspektori</b>	<b>Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare</b>	<b>Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik</b>	<b>Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes</b>	<b>Aktvendime</b>	<b>Kërkesa për gjykatat kompetente</b>
<b>I Tregut</b>	<b>165</b>	<b>58</b>	<b>65</b>	<b>12</b>	<b>7</b>
<b>I Ndërtimit</b>	<b>32</b>	<b>12</b>	<b>12</b>		
<b>Mbrojtjes së Ambientit *</b>					
<b>I veterines</b>	<b>50</b>	<b>40</b>	<b>27</b>		
<b>Sanitar</b>	<b>268</b>	<b>16</b>	<b>296</b>	<b>12</b>	<b>3</b>
<b>I bujqësisë</b>	<b>110</b>	<b>65</b>	<b>35</b>	<b>12</b>	
<b>GJITHSEJT</b>	<b>625</b>	<b>191</b>	<b>435</b>	<b>36</b>	<b>10</b>

**Në tabelën përmbledhëse nuk janë të përfshira të dhënat nga Inspektorja e Ambientit**

**\*Deri në kohën për dorëzimin e këtij raporti, Inspektorja e Ambientit, për arsye ende të pa justifikuara, nuk ka dorëzuar raport për punët e kryera.**

**Halil Tolaj**

